



KOMUNA KLINE

ZYRA E PROKURIMIT

01-NR. 351-34376/19
14.08.2019

Bazuar ne LPP 04/L-042 I ndryshuar dhe amandaetuar ne Ligjin nr.05/L-068 dhe 05/L-092 , neni 108/A , zyra e prokurimit ,me date 14.08.2019 ,ne përgjigje te Kërkesës për Rishqyrtim te O.E . merr :

VENDIM

HUDHET E PA BAZUAR KERKESA EPER RI SHQYRTIM E O.E “SHKODRANI “ NGA KLINA , te bere me date 12.08.2019 për procedurën e prokurimit Nr. 634-19-4428-521 Nr. Intern 634-19-044-521 Asfaltimi i rrugëve dhe Infrastrukturës nëntokësore ne Poterq –Faza Dyte

Arsyeshmeri

O.E “ SHKODRANI “NGA KLINA , ne Kerkesen per Rishqyrtim ka numruar shkeljet e pretenduara ne këto nene te LPP .

- 1. Neni 1 i LPP-se , Qëllimi i Ligjit, citojmë:** Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.
- 2. Neni 6 i LPP-se , Ekonomiciteti dhe efikasiteti i Ligjit, citojmë:** Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit.

Pergjigje e A.K. , pikërisht nenet 1 dhe 6 qe pretendon O.E Ankues ka qene qe Oferta fituese te beje te mundur Ruajtjen e buxhetit te Komunes dhe jo te shpërblehet ooferta e O.E , nkues



3. Neni 7 i LPP-se, Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi i Ligjit, citojmë:
Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.
4. Neni 59 i LPP-se, Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave dhe
5. Neni 60 i LPP-se, Kriteri i dhënies, Tenderi i përgjegjshëm, Qmimi më i ulët

Pergjigje e A.K. ka trajtuar ne perputheshmeri duke mos favorizuar asnjërin nga operatorët ekonomik dhe Oferta e ankuesit nuk eshte shpërblyer me kontrta meq nuk ishte me çmimin me te ulet .

6. Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale (Nuk është respektuar).

Asnera nga pretendimet e Ankuesit nuk qëndrojnë dhe A.K ka shpërblyer me kontrte O.E te pergjegjeshem me çmimin me te ulet qe per A.K, diferenca eshte e theksuar ,

DHE PIKERISHT NE ATO QE EDHE VETE ANKUESI KONSIDERON SE A.K DUHET TE KUJDESET PER PARAN PUBLIKE NUK ESHTË SHPERBLYER OFERTA E TYRE QE ESHTË PER 14.359.44 € ME E SHTREJTE QE PER BUXHETIN E A.K. ESHTË SHUME E PA JUSTIFIKUESHME ,

Baza juridike

Kunder këtij vendimi O.E , bazuar ne Nenin 109 te LPP ka te drejte te paraqes ankes pranë OSHP .

Abaz Foniqi

Abaz Foniqi d.v.

